



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 25/84 prot.

Shkodër, me 09 . 12 .2025

**NJOFTIM**

*Për thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak*

**Të nderuar këshilltarë,**

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Shkodër”, miratuar me Vendimin Nr.60, datë 28.12.2020, njoftoj thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak ditën **e Premte datë 19.12.2025 ora 17:00** , me rend dite si më poshtë:

*Miratimi i Procesverbalit të Mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak datë, 27.11.2025 sipas ligjit Nr.8480 datë, 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, neni 16 pika 2.*

1. *Projektvendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Nëntor 2025”.*
2. *Projektvendim: “Për plotësimin e vakancës dhe dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak.”.*
3. *Projektvendim: “Për miratimin e nivelit të bursave për nxënësit e viteve të para, viteve të dyta e lart të shkollave të mesme, për vitin shkollor 2025-2026”.*
4. *Projektvendim: “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKB nr.1, datë 22.01.2025 “Për Taksat dhe Tarifat vendore në Bashkinë Shkodër ”, i ndryshuar.*
5. *Projektvendim: “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe buxhetit vjetor 2027”.*
6. *Projektvendim: “Për miratimin e planit të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Shkodër për vitin 2026”.*

7. *Projektvendim: "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026-2028 të Bashkisë Shkodër".*

8. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

### **Grafiku i mbledhjeve të komisioneve**

| <b>Nr.</b> | <b>Komisione</b>                                                                                                                             | <b>Dita</b> | <b>Data</b> | <b>Ora</b> |
|------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|-------------|------------|
| 1          | Komisioni i Rinisë dhe Sportit/ Komisioni i Kulturës dhe Trashëgimisë                                                                        | E Premte    | 12.12.2025  | 10:00      |
| 2          | Komisioni i Shëndetësisë, Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit/ Komisioni i Bujqësisë, Menaxhimit të Ujërave dhe Mbrojtjes së Mjedisit | E Premte    | 12.12.2025  | 11:30      |
| 3          | Komisioni i Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit/ Komisioni i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit                                          | E Premte    | 12.12.2025  | 13:00      |
| 4          | Komisioni i Arsimit/ Komisioni i Shërbimeve Publike                                                                                          | E Premte    | 12.12.2025  | 14:30      |
| 5          | Komisioni i Rendit Publik dhe Mbrojtjes Civile                                                                                               | E Hënë      | 15.12.2025  | 10:00      |
| 6          | Komisioni i Shërbimeve Sociale / Komisioni i Barazisë Gjinore                                                                                | E Hënë      | 15.12.2025  | 11:30      |
| 7          | Komisioni i Financave, Buxhetit dhe Aseteve Publike/ Komisioni për Çështjet Ligjore                                                          | E Hënë      | 15.12.2025  | 13:30      |

*Duke Ju falënderuar,*

